



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:182214

Datë: 25.10.2024

Numri i dokumentit: 06349310

P.nr.740/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Dardane Ismaili, me bashkëpunëtoren profesionale Liridona Musliu Bekteshi në çështjen penale ndaj të akuzuarit N.J.për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1798/22 të datës 15.12.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me datë 16.10.2024, në mungesë të të gjitha palëve në procedurë, me datë 21.10.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 25.10.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

N... J... me nofken Q..., nga i ati M..., e ëma B..., e gjinisë M..., i lindur me datë ... në Mitrovicë, me vendbanim në Rr. “...” Mitrovicë-Veri, nr. personal ..., ka të kryer shkollën e mesme- teknik i veterinarisë, punon si vozitës,i martuar, baba i një fëmiju, i gjendjes së mesme ekonomike, serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLET FAJTOR

SEPSE:

Më datë 18.08.2022 rreth orë 18:00 në rrugën K.M. në Mitrovicë-Veri konkretisht përpara lokalit A., i pandehuri me dashje i shkakton lëndime trupore personit tjetër dhe atë të dëmtuarit Q.H. ashtu që ditën kritike derisa i dëmtuari Q.. ka qenë duke biseduar me babain e të pandehurit lidhur me veturën që babai i të pandehurit i'a kishte shitur të dëmtuarit Q..., në shumë prej 800 euro dhe parat ende nuk i kishte marr dhe kur i dëmtuari ishte nisur në drejtim të veturës së tij papritmas kishte shkuar tani i pandehuri N... dhe me mjet të fortë e kishte goditur në kokë, ku si pasojë e goditjes i dëmtuari ishte rrëzuar në tokë dhe nga ekspertiza mjekoligjore ishin konstatuar se i dëmtuari kishte pësuar lëndime të lehta trupore me pasojë të përkohshme për shëndetin.

- Me këtë ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

- Gjykata në mbështetje të nenit 1,4, 7,17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 79 dhe nenit 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së e lidhur me nenet 364, 365, 366, 449, 452 dhe 462 të KPP-së të akuzuarit N.J. :

## SH Q I P T O N

I.DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje 180 (njëqindetëdhjetë) ditë. Ky dënim do të ekzekutohet pesëmbëdhjetë (15) ditë, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, i cili dënim konform nenit 44 par. 1 të KPRK-së i:

ZËVENDËSOHET ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej njëmijëedyqind (1200) euro, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro), do ti caktohet një ditë burgim.

II. OBLIGOHET, i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëzetë euro (20), si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro, në tërësi shumën prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

III. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.1798/22 të datës 15.12.2022, ndaj të akuzuarit N.J. për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 17.10.2024, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Albana Parduzy, i akuzuari N.J., mbrojtësi i të akuzuarit N.J. sipas autorizimit me shkrim av. Sh.S., i dëmtuari Q.H.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, të akuzuarit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ashtu që në këtë seancë i akuzuari lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se: e pranoj fajësinë në tërësi sipas aktakuzës si dhe jam penduar shumë si dhe premtoj se në të ardhmen më asnjëherë nuk do të përsërisë vepra të tilla, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, i kërkon falje gjykatës dhe të dëmtuarit.

Prokurori i Shtetit Albana Parduzy lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ngase pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij

konform dispozitave ligjore te nenit 242 të KPPRK-së, pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Andaj, gjykatës i propozojmë që i pandehuri të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese të merr parasysh dashjen në kryerjen e veprës penale, motivin e kryerjes së veprës penale e që lidhet me një borxh, fakti që me këtë vepër është rrezikuar vlera e mbrojtur që është jeta dhe trupi i njeriut.

I dëmtuari lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar se mbështet fjalën e prokurores, i propozon gjykatës që të bëjë miratimin e fajësisë, si dhe sa i përketë llojit dhe lartësisë së dënimit ia lë gjykatës që të vendosë.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.J., av. Sh.S. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: pas konsultimit të mjaftueshëm me të mbrojturin tim konsideroj se i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet të lirë dhe i vetëdijshëm për natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe një pranimi i tillë i fajësisë ka mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, andaj i propozoj gjykatës të miratojë pranimin e fajësisë të deklaruar nga i pandehuri. Ndërsa lidhur me rrethanat për matjen e dënimit i njëjti ka deklaruar se, i propozoj gjykatës që me rastin e caktimit të shqiptimit të llojit dhe lartësisë të sanksionit penal t'i marr parasysh një mori rrethanash lehtësuese të cilat ekzistojnë në anën e të mbrojturit tim e posaqërisht: faktin që është i moshës së re, është i martuar, baba i një fëmiju, më parë i pagjykuar, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, se është penduar, premtimin se në të ardhmen nuk do të ndërmer veprime tjera, pranimin e fajësisë, andaj i propozojmë gjykatës që të njëjtit t'i shqiptoj një dënim të kushtëzuar ose një dënim me burg minimal i cili dënim do të shëndrrohet në dënim me gjobë pasi që konsideroj se është dënim adekuat nga rrethanat e lartëcekura dhe me të do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i akuzuari, e në mbështetje të nenit 242 të KPPRK-së, në këtë drejtim ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të akuzuarin.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke e njoftuar të akuzuarin se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, nga këto arsye gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari.

Gjykata ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore, as gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës si: shkresat sipas kallëzimit penal nr ..., Raporti policor i datës 18.08.2022, Procesverbali i marrjes në pyetje të të dëmtuarit/dëshmitarit Q.H., Procesverbal mbi marrjen në pyetje të

dëshmitarit M.J., Procesverbal mbi marrjen në pyetje të të pandehurit N. J., Raportet mjekësore, Ekspertiza mjekoligjore e datës 01.10.2022, Fotodokumentacioni si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari N.J. ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, e për të cilën veprë është paraparë dënimi me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vite.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Gjkata, si rrethana rënduese, ka vlerësuar shkallën e lartë të dashjes të kjo veprë penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë e veprës penale.

Ndërsa, si rrethana lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale nga i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar, pendimin e thellë për veprën e kryer, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërisë më veprime të tilla si dhe faktin se i pandehuri është njeri familjar, nuk ka qenë më parë i dënuar për ndonjë veprë penale, nuk zhvillohet asnjë rast tjetër penal, faktin se është penduar, kërkimfaljen.

Gjkata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit. Po ashtu gjykata vlerëson se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 të KPRK-së, që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin lidhur me zëvendësimin e dënimit me burgim me dënim me gjobë, gjykata e mori konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, i cili parasheh: "Kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar".

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në kuptim të nenit 449 par.2 nën par.2.6 dhe nenit 452 par.1 të KPRK-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën par 3.1 të Ligjit numër 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata nuk ka vendosur, pasi që një kërkesë e tillë nuk ishte parashtruar.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 364 par.1 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2022:182214  
Datë: 25.10.2024  
Numri i dokumentit: 06349310

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË  
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni penal  
P.nr.740/22, datë: 25.10.2024

G j y q t a r j a  
Dardane Ismaili

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimet të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.